



Komuna e Klinës  
Kryetari i Komunës  
01Nr.351-37352/2023  
Klinë, date 01/11/2023

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 35 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nr.04/L-042 publikuar ne Gazetën Zyrtare nr.18/2011, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh kerkesën e menaxherit të kontratës të dates 01.01.2023, krytari i Komunës së Klinës, lëshon **këtë**:

## V E N D I M

1. **LEJOHET**, kryerja e puneve shtese sipas kerkeses së menaxherit të projektit- kontratës, nr.01-351-23421/23 të datës 17.07.2023 "Asfaltimi i Rrugeve dhe Infrastruktures Nëntokësore Zllakuqan- Pataqan- Berkovë". Punet shtesë lejohen brenda limiteve dhe rregullave ligjore të prokurimit publik.
2. Arsyeja e lejimit të puneve shtese perkatasisht dhënia e këtij pelqimi, behet më kerkesë të menaxherit, për shtimin e kryerjes së puneve të paparashikuara më qellim të realizimit të projektit në teresi sipas standardeve.
3. Ky vendim lëshohet më kerkesen e menaxherit të projektit e cila është pjese perberese e këtij vendimi së bashku më paramasat dhe parallogarite e punëve shtese të cilat nuk mund të kalojne 10 % të vlerës së përgjithshme të projektit.
4. Zbatimi i ketij vendimi behet nga ana e zyres së prokurimit në bashkepunim më DUMM dhe operatorin kontraktues.

Të njoftohen:

- DUMM- menaxheri i kontratës
- Punekryesi, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,  
Zenun Elezaj

